

VENDIM
Nr. 984, datë 9.12.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E SHËRBIMIT
TË TRUPIT DIPLOMATIK TE MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN, PËR ENTIN
KOMBËTAR TË BANESAVE ME QËLLIM PRIVATIZIMI, TË DISA PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË GODINËN NR. 57, NË BULEVARDIN “ZOGU I
PARË”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 450, DATË 16.6.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 13, 15, shkronja “c” e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik te Ministria e Zhvillimit Urban, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi, të disa pronave të paluajtshme shtetërore në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, me numër pasurie 6/217-1+1 dhe 6/217-2+21, në zonën kadastrale nr. 8350, Tiranë, sipas listës nr. 1 dhe hartës treguese të pronës, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pronat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 450, datë 16.6.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të lidhë kontratat e privatizimit me personat e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara në udhëzimin nr. 17, datë 17.10.2012, të ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, “Për procedurat e shitjes së banesave pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Zhvillimit Urban, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama